



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Nr. _____ Prot.
____/____/2018

Tiranë, _____ më

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data: 24/09/2018

Nga: Autoriteti Kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit
Adresa: Rr. “Abdi Toptani”, Tiranë

Për: “VETEFARM-JUGU” sh.p.k. me Nr. NIPTI L72926601Q
Adresa: Lagjja “18 Shtatori”, Rruga “Javer Rushiti”, Gjirokastrë

Procedura e prokurimit: “Blerje të medikamenteve dhe mjeteve mjekësore veterinare”, “E Hapur” me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-68019-05-09-2018

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Blerje të medikamenteve dhe mjeteve mjekësore veterinare për të realizuar procesin e sterilizimeve të qenëve endacakë në qytetin e Tiranës.

Fondi limit total: 17 500 000 (shtatëmbëdhjetë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Financim nga Bashkia Tiranë në mbështetje të Vendimit Nr.132 datë 21.12.2017 të Këshillit Bashkiak të Tiranës për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018”.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 25.06.2018

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik **“ALMedical” sh.p.k.** me Nr. NIPTI: K01621001F me operatorin ekonomik **“ANIPHARMA” sh.p.k.** me Nr. NIPTI: K23724401H, kanë paraqitur ofertën ekonomike 17 150 000 (shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik **“Milifar” sh.p.k.** me Nr. NIPTI: J81426001I, ka paraqitur ofertën ekonomike 14 747 580 (katërmëdhjetë milion e shtatëqind e dyzetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik **“VETEFARM-JUGU” sh.p.k.** me Nr. NIPTI: L72926601Q, ka paraqitur ofertën ekonomike 17 399 000 (shtatëmbëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik **Kristaq Skenderi P.F.** me Nr. NIPTI: K32720203N, ka paraqitur ofertën ekonomike 16 798 303 (gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e treqind e tre)lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik **“ALMedical” sh.p.k.** me Nr. NIPTI: K01621001F me operatorin ekonomik **“ANIPHARMA” sh.p.k.** me Nr. NIPTI: K23724401H.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë në të njëjtin orar me hapjen e ofertave (ora 11:00) dorëzuan 43 (dyzetë e tre) nga 43 (dyzetë e tre) mostrat e kërkuara referuar procesverbalit Nr. 1256 prot., datë 25.06.2018.

Në shtojcën 10 **“Specifikimet teknike”** të Dokumentave Standarte të Tenderit është specifikuar se: *“Data e skadencës në ditën e dorëzimit të mostrave duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit”.*

Nga kontrolli i mostrave rezulton se:

- Artikulli Nr.3 *Vaksina Tërbimi 2 UI shtami Pasteur RIV* ka afat përdorimi deri më datë 30.03.2019.
- Artikulli Nr.12 *Spray Postoperator oxytetraciline 3.58% 140 gr* ka afat përdorimi deri më datë 24.01.2019.

- Për artikullin Nr.31 *Ketaxyl 30 ml ose ekuivalent*, mostra e sjellë është Ketaxyl 30 ml me afat përdorimi deri në **Gusht 2018**, afat i cili është shumë i shkurtër dhe përkon afër periudhës së zhvillimit të procedurës së prokurimit.
Në shtojcën e hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik më datë 11.06.2018 ky artikull është modifikuar duke shtuar termin “ose ekuivalent”, duke ju referuar nenit 23/5 të LPP, i cili parashikon se: “*Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.*” Nga ana e operatorit ekonomik nuk është sjellë asnjë artikull ekuivalent që të jetë brenda afateve të kërkuara të përdorimit.
- Artikulli Nr.43 *Ushqim për qen* ka afat përdorimi deri më datë 26.01.2019.
- Artikulli Nr.20 *Garza Sterile 10*10 cm* mostra e sjellë nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara, nuk është sterile por pambuku.

2. Operatori ekonomik “Milifar” sh.p.k. me Nr. NIPTI: J81426001I.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik në të njëjtin orar me hapjen e ofertave (ora 11:00) dorëzoi 42 (dyzetë e dy) nga 43 (dyzetë e tre) mostrat e kërkuara referuar procesverbalit Nr. 1256 prot., datë 25.06.2018.

Në shtojcën 10 “*Specifikimet teknike*” të Dokumentave Standarte të Tenderit është specifikuar se: “*Data e skadencës në ditën e dorëzimit të mostrave duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit*”.

Nga kontrolli i mostrave rezulton se:

- Artikulli Nr.7 *Amoxicilinë La 100 ml* ka afat përdorimi deri në Maj 2019.
- Artikulli Nr.18 *Suture USP Nr:1 PGA+age* ka afat përdorimi deri në Prill 2019.
- Për artikullin Nr.12 *Spray Postoperator oxytetraciline 3.58% 140 gr*, janë sjellë 3 (tre) mostra prej të cilave asnjëra nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara. Dy nga mostrat janë me përqëndrim 2% dhe tjetra 1.78 %.
- Për artikullin Nr.25 *Përparëse operimi një përdorimshe*, mostra e sjellë është përparëse e zakonshme pune dhe jo e përshtatshme për sallë operimi.
- Për artikullin Nr.42 *Shtroje për qentë*, mostra e sjellë është tapet për përdorim shtëpiak dhe jo sipas specifikimit të kërkuar.
- Për artikullin Nr.43 *Ushqim për qen*, mostra e sjellë nuk është e plotë pasi është paraqitur vetëm ambalazhi dhe produkti më vete në qese plastike, duke mos vërtetuar vërtetësinë e mostrës.
- Artikulli Nr. 28 *Lak special për kapjen e qenve* nuk është paraqitur, mungon.

3. Operatori ekonomik **Kristaq Skenderi** P.F. me Nr. NIPTI: K32720203N.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik në të njëjtin orar me hapjen e ofertave (ora 11:00) nuk dorëzoi asnjë nga

43 (dyzetë e tre) mostrat e kërkuara referuar procesverbalit Nr. 1256 Prot., datë 25.06.2018.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “VETEFARM-JUGU” sh.p.k. me Nr. NIPTI: L72926601Q, Adresa: Lagjja “18 Shtatori”, Rruga “Javer Rushiti”, Gjirokastër, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme 17 399 000 (shtatëmbëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta më e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Rr. “Abdi Toptani”, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Së bashku me sigurimin e kontratës duhet të sillni të gjithë dokumentacionin e paraqitur në tender (origjinal ose fotokopje e noterizuar), i cili verifikohet nga KVO dhe bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, procedura e prokurimit do të anulohet për mungesë konkurrence, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.06.2018

Ankesa: Në datën 02.07.2018 pranë zyrave të Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, u paraqit ankesa me Nr.1332 Prot. nga operatori ekonomik “Milifar” shpk .

Operatori ekonomik u vu në dijeni për përgjigjen me shkresën Nr.1332/2 Prot. datë 04.07.2018.

Në datën 20.07.2018 jemi vënë në dijeni me shkresën Nr.1498 Prot., për vendimin me Nr.1258/1 Prot., datë 18.07.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Në datën 21.09.2018 jemi vënë në dijeni me shkresën Nr.1878 Prot., për vendimin me Nr.617/2018 Prot., datë 20.09.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Në datën 03.07.2018 pranë zyrave të Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, u paraqit ankesa me Nr.1337 Prot. nga bashkimi i operatorëve ekonomik “ALMedical” sh.p.k. me operatorin ekonomik “ANIPHARMA” sh.p.k.

Operatori ekonomik u vu në dijeni për përgjigjen me shkresën Nr.1337/2 Prot., datë 04.07.2018.

Nuk u paraqit ankesë nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALMedical” sh.p.k. me operatorin ekonomik “ANIPHARMA” sh.p.k. pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Rudina Hoxha

